



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3653/21 prot.

Datë 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 422/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 117/2026, datë 22.01.2026 për procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “*Ristrukturim Hardëare të Server Room*”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.

Ankimues: Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK me NUIS K21710002J dhe adresë: Rr. Murat Toptani, Godina Eurocol, Tirane.

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane
Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 117/2026, ku vendosi:

Vendosi

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “Ristrukturim Hardëare të Server Room”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datën 11.03.2026 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr.380/2026,ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: “Ristrukturim Hardëare të Server Room”, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimin e dokumentave të tenderit në përputhje me konstatimin e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.3. Me shkresën nr. 18453/18 prot., datë 19.03.2026, me objekt: “Informacion mbi zbatimin e vendimit me nr. 380/2026 , datë 11.03.2026 ””, protokolluar me tonën nr. 3653/18 prot., datë

24.03.2026, autoriteti kontraktor informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 380/2026, datë 11.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 18453/18 prot., datë 19.03.2026, me objekt: *“Informacion mbi zbatimin e vendimit me nr. 380/2026 , datë 11.03.2026”* , protokolluar me tonën nr. 3653/18 prot., datë 24.03.2026, autoriteti kontraktor informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 380/2026, datë 11.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.”

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.117/2026, datë 22.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit të mësipërm, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *“E hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr. REF-71913-12-11-2025, me objekt: *“Ristrukturim Hardëare të Server Room”*, me fond limit 20,000,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 12-01-2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

